



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik

Drejtoria për Buxhet dhe Financa



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data 26.05.2026	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
05	400/03-12323	-1.

NJOFTIM PUBLIK

Për konsultim publik lidhur me Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Kaçanikut 2027–2029

Komuna e Kaçanikut, përmes Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me Zyrën për Informim, njofton qytetarët, institucionet, organizatat joqeveritare, përfaqësuesit e sektorëve të ndryshëm dhe të gjitha palët e interesuara se është publikuar për konsultim publik Draft Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Kaçanikut 2027–2029.

Ky proces zhvillohet duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Kaçanikut, si dhe nenin 23 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna.

Draft dokumenti është i hapur për konsultim publik nga data 26.05.2026 deri më 15.06.2026, ndërsa dëgjimet publike do të mbahen sipas orarit në vijim:

Orari i dëgjimeve publike

Aktiviteti	Data	Ora	Vendi
Dëgjim publik me sektorin e arsimit	05.06.2026	10:30	Gjimnazi "Skënderbeu"
Dëgjim publik me qytetarët e Komunës së Kaçanikut	09.06.2026	14:00	Salla e Kuvendit Komunal

Komentet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni deri më datën 16.06.2026, në ora 16:00, tek Udhëheqësja e Sektorit për Buxhet dhe Financa, znj. Fitore Vishi, në emailin:

fitore.vishi@rks-gov.net.

Draft dokumenti i Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Kaçanikut 2027–2029 është i publikuar edhe në webfaqen zyrtare të Komunës së Kaçanikut:

<https://kacanic.rks-gov.net/shpalljet/>

Komuna e Kaçanikut fton qytetarët dhe të gjitha palët e interesuara që të marrin pjesë në dëgjimet publike dhe të kontribuojnë me propozime, komente dhe sugjerime për hartimin sa më përmbytësor dhe gjithëpërfshirës të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2027–2029.

Ftoheni për pjesëmarrje.